

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Prodhim i lendes drusore”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Prodhim i
lendes drusore, 03419000-0**

VLERA E FONDIT LIMIT: 35 833 333 (tridhjetë e pesë milion e tetëqind e tridhjetë e tre mijë
e treqind e tridhjetë e tre) **Lekë pa Tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe
nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit
publik”, autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit ka hartuar procesverbalin
për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për
procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Do të plotesohen me plotesimin e kapacitetit të përgjithshëm.

1.1 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

Për të provuar kapacitetin financiar dhe ekonomik, Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021,
2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur
janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 “Për

auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasi vit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të lëshuara nga administrata tatimore për gjatë tre viteve të fundit, 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të prokuruar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

3. Operatori ekonomik të paraqesë një vërtetim që ka paguar taksat dhe tarifave vendore për vitin 2023 për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB-së). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetimin për taksat dhe tarifave vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e TaksaveVendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” I ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dheneni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.3 Për kapacitetin teknik:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme:

Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasinë e mallrave të furnizuara,

Ose

- b) Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat, si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, dhe të

deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Duke qenë se vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar, vlera për furnizime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës. Per kete arsye eshte kerkuar një ose disa furnizime të ngjashme në vlerën sa 40% e vleres se kontratës.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik/ofertuesi duhet të paraqesë Licensën Profesionale të Shoqërisë duke dëshmuar që zotëron këto kategori lidhur me zotërimin e punëve të kontratës:

Kodi III-7A “shërbime të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me pyjet apo kullotat” lëshuar nga QKL

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, gërma ”a” e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, licenca e mësipërme që kërkohen janë të lëshuara nga QKL dhe licencat është e lidhur ngushtësisht me objektin e prokurimit, sejcila prej tyre është e përfshirë në fushën e gjelbërimit dhe kërkimi i tyre që të zotërohen nga OE pjesëmarrës në procedurë tregon kualifikim dhe cilësi.

2.3.3 Të ketë zhvilluar aktivitetin për trajtimin dhe vjeljen e materialit drusor në pyje jo më pak se **5 vjet**, të vërtetuara me kontrata dhe aktin e kolaudimit ose vërtetim nga institucioni përkatës, për kontratat e përfunduara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar legjislacionin e prokurimit publik si dhe Udhëzimin nr. 3, datë 03.03.2017, të Ministrit të Mjedisit, me qëllim që fituesi i mundshëm të zotërojë kapacitetet dhe përvojen e duhur në kryerjen e shërbimit objekt i kontratës.

2.3.4 Disponimi ose mundësia e sigurtë e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për egzekutimin e kontratës:

| Lloji i Makinerive | Njësia | Sasia |
|--|---------------|--------------|
| Kamion transporti me masë maksimale 3.5-10 ton | Copë | 3 |
| Ekskavator | Copë | 1 |
| Organellë ose traktor teknologjik | Copë | 1 |
| Motorrsharrë | Copë | 3 |

Të gjitha mjetet e lartpërmendura duhet të jenë të shoqëruara me fotot përkatëse.

Mjetet e lartpërmendura duhet të jenë në pronësi ose me qira dhe ofertuesi duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm:

a) Aktin e pronësisë së mjetit përkatës;

Ose

b) **Kontratën e marrjes me qira të mjetit**, shoqëruar me dokumentacioni përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale e të përfshijë afatin e realizimit të kësaj kontrate.

- Për mjetet në pronësi ose të marra me qira si më lart që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qira, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e mjeteve të mësipërme, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës.

Argumentimi: kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të nenit të 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si dhe nenit 41, pika 4, gërma “ç” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.5 Një punësim mesatar prej 15 (pesëmbëdhjetë) personave, për 3(tre) muajt e fundit të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;

- Listë - pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e fuqisë punëtore, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës.

Argumentimi: kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të nenit të 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si dhe nenit 41, pika 4, gërma “c” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.6 - Operatori duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë nga Administratori i Shoqërisë, Drejtuesin Teknik, i cili duhet të jetë i profesionit Inxhinier Pyjesh për të cilin duhet të paraqesë: Kontratë pune, Lejen Profesionale të ushtrimit të profesionit, si dhe të figurojë në list-pagesat e shoqërisë për 3 mujorin e fundit.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e drejtuesit teknik, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës.

Argumentimi: kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të nenit të 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si dhe nenit 41, pika 4, gërma “c” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Afati i kryerjes së shërbimit do të jetë nga data e nënshkrimit të kontratës deri më 31.12.2023.

Komisioni

Enea Përmeti

Andi Roshi

Enrik Stafa